

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR

MIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR PËRFSHIRJEN DHE AKSESUESHMËRINË E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA” - 2030”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” propozohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si institucionit përgjegjës për hartimin dhe koordinimin e politikave në fushën e përfshirjes sociale, me qëllim krijimin e një kuadri të plotë ligjor për garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale koordinon dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030, dokumenti strategjik ndërsektorial që synon përmirësimin e mirëqenies dhe cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me parimet dhe standardet e përcaktuara në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe në Strategjinë e Bashkimit Evropian për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2030.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian, Projektligji synon përafrimin e legjislationit shqiptar me Direktivën (BE) 2019/882 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 prill 2019, “Për kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet”, njohur si Akti Evropian për Aksesueshmërinë. Kjo Direktivë ka për qëllim të kontribuojë në harmonizimin e kërkesave të aksesueshmërisë për kategori të caktuara produkte dhe shërbimesh dhe të parandalojë barrierat e ndryshme për aksesueshmëri.

Gjithashtu, projektligji synon garantimin e aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të tyre në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

Projektligji ka për qëllim të krijojë mekanizmat dhe standardet për aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve duke eliminuar fragmentimin institucional dhe nxitur koordinimin ndërinstitutional.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i projektligjit për aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve kontribuon në realizimin e prioriteteve të programit politik qeverisës, në veçanti në drejtim të garantimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, forcimit të përfshirjes së tyre sociale dhe ekonomike dhe eliminimit të barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në shoqëri. Nëpërmjet përcaktimit të kërkesave të detyrueshme të aksesueshmërisë për mallra dhe shërbime të caktuara, projektligji synon të përmirësojë aksesin e personave me aftësi të kufizuara në mallra, shërbime, informacion, komunikim dhe teknologji, si dhe të nxisë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të projektuara dhe ofruara sipas parimeve të aksesueshmërisë dhe projektimit universal.

Projektligji është në përputhje me:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, miratuar me vendimin nr. 88, datë 22.2.2023, të Këshillit të Ministrave, duke kontribuar në objektivat që lidhen me përfshirjen sociale, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mosdiskriminimin dhe përafrimin e standardeve kombëtare me standardet e Bashkimit Evropian;
- Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030, i cili përcakton aksesueshmërinë, përfshirjen sociale dhe jetesën e pavarur si drejtime të rëndësishme të politikave kombëtare për aftësinë e kufizuar. Projektligji kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e këtyre objektivave, nëpërmjet vendosjes së kërkesave të aksesueshmërisë për mallrat dhe shërbimet dhe reduktimit të barrierave që kufizojnë përdorimin e tyre nga personat me aftësi të kufizuara;
- Procesin e integrimit evropian dhe detyrimet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian *Kapitulli 23 “Themeloret”*, përmes përafrimit me Direktivën (BE) 2019/882 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 prill 2019, mbi kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet (European Accessibility Act). Direktiva synon harmonizimin e kërkesave të aksesueshmërisë dhe eliminimin e barrierave në qarkullimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve të aksesueshme, duke rritur njëkohësisht mundësitë e personave me aftësi të kufizuara për t’i përdorur ato në mënyrë të barabartë me të tjerët.
- Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021–2030, e cila synon garantimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e jetës, nëpërmjet eliminimit të barrierave, përmirësimit të aksesueshmërisë dhe forcimit të të drejtave të tyre. Projektligji kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e këtyre objektivave, duke vendosur kërkesa të detyrueshme të aksesueshmërisë për mallra dhe shërbime dhe duke krijuar kushte për përdorimin e tyre nga personat me aftësi të kufizuara.
- Angazhimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, në veçanti me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht

parimet dhe detyrimet që lidhen me aksesueshmërinë, jetesën e pavarur, pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri dhe mosdiskriminimin.

- Agjendën e OKB-së 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, në veçanti të Objektivit 10 për reduktimin e pabarazive dhe Objektivit 11 për krijimin e qyteteve dhe komuniteteve gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme.
- Projektakti është pjesë e programit analitik të projektakteve ligjore dhe nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2026.

Në tërësi, projektligji forcon kalimin nga një qasje e bazuar vetëm në masa individuale mbështetëse drejt një qasjeje të bazuar në të drejta dhe në aksesueshmërinë universale, duke vendosur përgjegjësi konkrete për operatorët ekonomikë dhe autoritetet publike dhe duke krijuar kushtet që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në mallra dhe shërbime në mënyrë të barabartë me personat e tjerë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë e projektligjit lidhen me konsolidimin e përpjekjeve ligjore dhe institucionale për përcaktimin e kërkesave të detyrueshme për aksesueshmërinë e produkteve dhe shërbimeve që përfshihen në fushën e zbatimit të Direktivës 2019/882/BE.

Direktiva e Aksesueshmërisë 2019/882/BE ka një qëllim të dyfishtë duke synuar i) realizimin e të drejtave dhe përfshirjes sociale e aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe ii) shmangien e barrierave në lëvizjen e lirë të produkteve dhe shërbimeve që nevojiten në kontekstin kombëtar për aksesueshmërisë.

Projektligji synon krijimin e një kuadri ligjor të qartë dhe të unifikuar për garantimin e aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë dhe ushtrimit efektiv të të drejtave të tyre në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

Njëkohësisht, projektligji parashikon bashkërendimin e veprimtarive për problemet e personave me aftësi të kufizuara përmes Këshillit Kombëtar për Aftësi të Kufizuara, ministrive të linjës dhe institucioneve kryesore për përfshirjen sociale të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Aksesueshmëria e mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara përbën një element të rëndësishëm për garantimin e pjesëmarrjes së barabartë dhe të të drejtave themelore. Në këtë kuadër, ndërhyrja ligjore synon adresimin e problematikave që lidhen me mungesën e standardeve të detyrueshme kombëtare për aksesueshmërinë, fragmentimin institucional dhe mungesën e koordinimit ndërinstitutional, si dhe me mungesën e detyrimeve të qarta ligjore për sektorin privat.

Ndër problematikat që synohet të adresohen janë edhe mungesa e të dhënave mbi aksesin në mallra dhe shërbime, niveli i ulët i aksesueshmërisë së faqeve zyrtare dhe shërbimeve digjitale,

mungesa e kapaciteteve teknike dhe njohurive profesionale, si dhe zbatimi joefektiv i kërkesave ekzistuese për aksesueshmërinë.

Në lidhje me shërbimet, projektakti synon të adresojë përfshirjen e kufizuar të shërbimeve private në kërkesat për aksesueshmëri, mungesën e mekanizmave të qartë të mbikëqyrjes së shërbimeve të ofruara në distancë, mungesën e kërkesave për trajnimin e stafit që ofron shërbime në kontakt me publikun, si dhe zbatimin e pjesshëm të standardeve të aksesueshmërisë për faqet zyrtare dhe aplikacionet publike.

Projektligji ka në përmbajtje sipas parashikimeve të Direktivës 2019/882/BE:

- sigurimi i aksesit të barabartë në mallra dhe shërbime;
- përmirësimi i cilësisë së mallrave dhe shërbimeve publike dhe digjitale përmes përcaktimit të standardeve të qarta të aksesueshmërisë;
- zvogëlimi i fragmentimit institucional dhe sigurimi i koordinimit ndërinstitutional;
- forcimi i kapaciteteve të autoriteteve publike për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e përputhshmërisë së mallrave dhe shërbimeve me kërkesat e aksesueshmërisë;
- rritja e ndërgjegjësimit dhe përcaktimi i detyrimeve të operatorëve ekonomikë për përfshirjen e kërkesave të aksesueshmërisë në projektimin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve;
- promovimi i projektimit universal dhe i standardeve të aksesueshmërisë;
- zhvillimi i një sistemi efektiv monitorimi, raportimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm të zbatimit të kërkesave të aksesueshmërisë;
- forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe me shoqërinë civile;
- harmonizimi i legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian.

Projektligji parashikon krijimin e një kuadri ligjor për aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve, duke synuar përfshirjen e kërkesave të aksesueshmërisë në projektimin, prodhimin, ofrimin dhe përdorimin e tyre. Nëpërmjet këtij projektligji synohet përcaktimi i kërkesave të aksesueshmërisë për mallra dhe shërbime, si dhe vendosja e detyrimeve për operatorët ekonomikë që veprojnë në fushat përkatëse.

Ndër mallrat për të cilat do të parashikohen kërkesat e aksesueshmërisë përfshihen pajisjet teknologjike dhe IT, kompjuterët dhe sistemet operative, telefonat inteligjentë dhe pajisjet celulare, tabletët, ekranet dhe pajisjet interaktive, pajisjet radio-televizive dhe dekoderat, librat elektronikë dhe pajisjet e leximit elektronik, si dhe терминаlet e vetëshërbimit, automatikët e biletave, bankomatet dhe kioskat elektronike.

Në fushën e shërbimeve, projektakti synon të përfshijë komunikimet elektronike, shërbimet online dhe digjitale, shërbimet cloud dhe tregtinë elektronike, platformat e ofrimit të librave elektronikë, shërbimet audiovizuale, shërbimet e transportit dhe shërbimet bankare.

Efektet e pritshme nga miratimi dhe zbatimi i projektligjit lidhen me përmirësimin e aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve dhe rrjedhimisht me rritjen e mundësive për

pjesëmarrje të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Përcaktimi i kriterëve të aksesueshmërisë synon të kontribuojë në reduktimin e barrierave fizike, teknologjike dhe të komunikimit, si dhe në rritjen e pavarësisë dhe përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara.

Në aspektin institucional, projektligji pritët të kontribuojë në forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe në përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes, monitorimit dhe raportimit. Monitorimi i zbatimit do të mbështetet në të dhënat e mbledhura nëpërmjet sistemeve elektronike, raportimit periodik të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe konsultimit me operatorët ekonomikë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Në aspektin ekonomik dhe rregullator, vendosja e kërkesave të unifikuara të aksesueshmërisë synon të krijojë një mjedis më të qartë dhe të parashikueshëm për operatorët ekonomikë, të reduktojë fragmentimin e tregut dhe të lehtësojë përshtatjen me standardet evropiane të aksesueshmërisë. Në të njëjtën kohë, zbatimi i projektaktit do të kërkojë masa administrative dhe institucionale që lidhen me harmonizimin e legjislacionit, hartimin e akteve nënligjore, përditësimin e procedurave, trajnimin e stafit dhe forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe zbatimit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Miratimi i një ligji të ri pritët të krijojë një strukturë më të qartë dhe më të mirëorganizuar të parashikimeve ligjore, duke shmangur fragmentimin.

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me parimet themelore që garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazinë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. Në veçanti, ai është në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës, që garanton barazinë përpara ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe me nenin 59, lidhur me objektivat sociale të shtetit për përkujdesjen, integrimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara.

Projektligji respekton gjithashtu lirinë e veprimtarisë ekonomike, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Detyrimet që u vendosen operatorëve ekonomikë për sigurimin e aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve përcaktohen me ligj, ndjekin një interes të ligjshëm publik dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave, barazisë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër, projektligji parashikon edhe zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe shmangien e barrës joproporcionale për operatorët ekonomikë.

Në aspektin e ligjshmërisë, është në harmoni me kuadrin e përgjithshëm ligjor shqiptar për mbrojtjen nga diskriminimi, mbrojtjen e konsumatorëve, mbikëqyrjen e tregut dhe rregullimin e sektorëve të veçantë të mallrave dhe shërbimeve që përfshihen në fushën e tij të zbatimit. Projektligji synon të krijojë një kuadër të ri dhe të unifikuar ligjor për aksesueshmërinë, duke

zëvendësuar kuadrin aktual të përcaktuar nga ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili do të shfuqizohet me hyrjen në fuqi të ligjit të ri.

Në aspektin e detyrimeve ndërkombëtare, projektligji është në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht me parimet dhe detyrimet që lidhen me aksesueshmërinë, barazinë, mosdiskriminimin, jetesën e pavarur dhe pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Në veçanti, projektligji kontribuon në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 9 i Konventës për garantimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuara.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian në kuadër të negociatave për Kapitullin 23 “Themeloret”. Më konkretisht projektligji kontribuon në fushën e aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Akti i Bashkimit Evropian i identifikuar si bazë e përafrimit është Direktiva (BE) 2019/882 për kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet.

Projektakti është i parashikuar në PKIE, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe përafron kuadrin strategjik të BE.

Paketa me projektligjin dhe Tabelat e Përputhshmërisë, ku përfshihen dhe Aneksat e Direktivës është dërguar për konsultim pranë Komisionit Evropian dhe janë reflektuar komentet e tyre.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është organizuar në shtatë krerë, ku secili kre është i ndarë në nene me pika e paragrafë përkatës.

Kreu I “*Dispozita të përgjithshme*” [nenet 1-4], parashikon qëllimin dhe objektin e ligjit, përkufizon konceptet dhe institutet kryesore të përdorura në dispozitat vijuese, si dhe përcakton parimet e përgjithshme që udhëheqin zbatimin e tij. Projektligji synon të garantojë aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, eliminimin e barrierave dhe pengesave për ushtrimin e të drejtave të tyre, si dhe garantimin e jetesës së pavarur, autonomisë dhe pjesëmarrjes së barabartë në komunitet.

Risi e këtij projektligji është përcaktimi i një kuadri më të plotë të aksesueshmërisë, i cili ndërthur garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara me detyrimet konkrete të strukturave publike dhe jopublike dhe të operatorëve ekonomikë për mallrat dhe shërbimet. Në

këtë kuadër, parashikohen si parime themelore mosdiskriminimi, barazia, përfshirë barazinë gjinore, autonomia dhe pavarësia në vendimmarrje, aksesueshmëria, përfshirja dhe pjesëmarrja efektive, konsultimi me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese, si dhe realizimi progresiv i të drejtave në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Kreu II *“Aksesueshmëria e mallrave dhe shërbimeve”* [nenet 5-21], përcakton kategoritë e mallrave dhe shërbimeve që i nënshtrohen kritereve të aksesueshmërisë, kriteret e përgjithshme për garantimin e aksesueshmërisë së tyre, si dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në prodhimin, importimin, shpërndarjen dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve. Në fushën e zbatimit përfshihen, ndër të tjera, sistemet kompjuterike, терминаlet e vetëshërbimit, pajisjet e komunikimit elektronik, shërbimet e mediave audiovizive, pajisjet e transportit të pasagjerëve, shërbimet bankare, librat elektronike dhe tregtia elektronike, si dhe komunikimet drejt numrit unik të emergjencës 112. Projektligji vendos një sistem të plotë detyrimesh për garantimin e aksesueshmërisë përgjatë gjithë ciklit të mallit ose shërbimit, duke nisur nga projektimi dhe prodhimi, vlerësimi i konformitetit dhe markimi CE, deri te hedhja në treg, shpërndarja, ofrimi i shërbimit dhe mbikëqyrja e përputhshmërisë. Parashikohen detyrime të posaçme për prodhuesit, përfaqësuesit e autorizuar, importuesit, distributorët dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe rregulla për prezumimin e konformitetit, aksesueshmërinë në prokurimin publik, vlerësimin e ndryshimit thelbësor dhe barrës joproporcionale, masat korrigjuese dhe tërheqjen e mallrave nga tregu. Gjithashtu, projektligji përcakton mekanizmat e mbikëqyrjes së mallrave dhe shërbimeve dhe masat që ndërmerren në rast të mospërmbushjes së kritereve ose detyrimeve formale të aksesueshmërisë.

Kreu III *“Autoritetet përgjegjëse, kundërvajtjet administrative dhe sanksionet mbi aksesueshmërinë”* [nenet 22-31], përcakton kuadrin institucional përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kërkesave të aksesueshmërisë, duke përcaktuar përgjegjësitë e ministrive dhe autoriteteve rregullatore sipas fushave të tyre të kompetencës. Si autoritete kryesore përgjegjëse përcaktohen ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, ministria përgjegjëse për ekonominë dhe inovacionin, ministria përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën dhe ministria përgjegjëse për punët e brendshme. Në varësi të sektorit, funksione të posaçme mbikëqyrëse ushtrohen edhe nga Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive. Ky kre parashikon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve, informimin e publikut dhe operatorëve ekonomikë, si dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të aksesueshmërisë.

Në vijim, kreu përcakton sistemin e masave korrigjuese dhe të sanksioneve administrative për rastet e mospërmbushjes së kritereve të aksesueshmërisë. Qasja e parashikuar është graduale dhe proporcionale, duke parashikuar fillimisht paralajmërimin dhe detyrimin për marrjen e masave korrigjuese kur mospërputhja është e korrigjueshme dhe nuk paraqet rrezik serioz. Shkeljet klasifikohen në të lehta, të rënda dhe shumë të rënda, duke marrë në konsideratë natyrën dhe shkallën e mospërputhshmërisë, ndikimin mbi personat me aftësi të kufizuara, numrin e mallrave ose shërbimeve dhe të personave të prekur, kohëzgjatjen dhe përsëritjen e

shkeljes, si dhe bashkëpunimin e operatorit ekonomik me autoritetin përgjegjës. Për shkeljet parashikohen sanksione administrative përshkallwzuese.

Kreu IV “*Jetesë e pavarur*” [nenet 32-36], përcakton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet në mënyrë të pavarur, duke respektuar zgjedhjet, vullnetin dhe preferencat e tyre. Në këtë kuadër, politikat shtetërore synojnë të krijojnë kushtet që këta persona të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në fusha si strehimi, arsimi, punësimi, shërbimet shoqërore dhe shëndetësore, transporti, komunikimi, jeta publike dhe aksesimi në mallra e shërbime. Ky kre parashikon forma konkrete mbështetjeje për jetesën e pavarur, si asistenca personale, vendimmarrja e mbështetur dhe mjetet ndihmëse, duke vendosur në qendër nevojat dhe zgjedhjet individuale të personit me aftësi të kufizuara. Në mënyrë të veçantë, projektligji garanton që personi të ketë rol aktiv në organizimin dhe menaxhimin e mbështetjes që merr, përfshirë të drejtën për të zgjedhur dhe udhëzuar ndihmësin personal. Po ashtu, parashikohet sigurimi dhe mbështetja financiare për mjetet ndihmëse, me qëllim kapërcimin e pengesave dhe rritjen e autonomisë dhe pjesëmarrjes së barabartë në shoqëri. Në tërësi, këto dispozita e zhvendosin fokusin nga një qasje thjesht përkujdesëse drejt një modeli që mbështet pavarësinë, zgjedhjen dhe kontrollin e vetë personit mbi jetën e tij. Dispozitat e këtij kreu janë mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 93/2014, por synojnë të japin një mbrojtje më të plotë konform standardeve ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Kreu V “*Vlerësimi i aftësisë së kufizuar dhe nevojave për mbështetje*” [nenet 37-42], rregullon mënyrën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe të nevojave për ndihmë e mbështetje, duke e bazuar këtë proces në një qasje multidisiplinare dhe në Klasifikimin Ndërkombëtar për Funksionimin, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndetin (ICF), me qëllim që vlerësimi të marrë në konsideratë jo vetëm gjendjen individuale, por edhe faktorët socialë dhe pengesat që ndikojnë në pjesëmarrjen e personit në shoqëri. Kreu parashikon mbështetjen financiare nga Buxheti i Shtetit dhe detyrimin e institucioneve qendrore dhe vendore për të planifikuar gradualisht fondet e nevojshme për eliminimin e pengesave në ofrimin e shërbimeve publike. Në vijim, përcaktohen përbërja, funksionimi dhe detyrat e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, si organ këshillimor që përfshin përfaqësues të institucioneve publike, personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre. Një rëndësi e veçantë i kushtohet bashkërendimit ndërinstitucional, përmes caktimit të nëpunësve përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe vendor. Po ashtu, projektligji forcon pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre në proceset e konsultimit publik, duke u njohur edhe të drejtën e ankimit kur kjo e drejtë nuk respektohet.

Kreu VI “*Mbështetja për zbatim*” [nenet 43-44], parashikon masat për mbështetjen e zbatimit të politikave të aksesueshmërisë dhe përfshirjes. Në këtë kuadër, INSTAT-i dhe institucionet përgjegjëse ngarkohen me mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për aftësinë e kufizuar, ndërsa Qeveria dhe media publike e private kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, shmangien e stereotipeve dhe promovimin e autonomisë, vetëpërfaqësimit dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Kreu VII “*Dispozita të fundit*” [nenet 45-47], përcakton aktet nënligjore që duhet të miratohen

për zbatimin e ligjit, shfuqizimin e ligjit nr. 93/2014 dhe vijimin e përkohshëm të akteve nënligjore ekzistuese deri në zëvendësimin e tyre. Hyrja në fuqi parashikohet sipas rregullit të përgjithshëm 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen:

- Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar;
- Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe inovacionin;
- Ministria përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën;
- Ministria përgjegjëse për punët e brendshme;
- Banka e Shqipërisë;
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);
- Strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për mallrat joushqimore;
- Institucionet dhe autoritetet sektoriale përgjegjëse për mbikëqyrjen e shërbimeve, sipas fushës së kompetencës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji propozuar është përgatitur në zbatim të Urdhërit Nr. 623, Datë 18.1./2025 “Për ngritjen e grupit ndërinstitutional për rishikimin e ligjit Nr. 93/2014: “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Në kuadër të procesit të integritetit të vendit në BE, si dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin, janë zhvilluar takime konsultative dhe koordinuese me institucionet përgjegjëse, institucionet e pavarura, pushtetin vendor dhe organizatat e shoqërisë civile.

-

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja totale e përllogaritur për zbatimin e masave administrative Projektligjit e cila rezulton nga RIA është prej

Analizë të detajuar financiare dhe me matrica të kostuara për secilën masë dhe aktivitet të parashikuar.

Procesi i kostimit është mbështetur në konsultime me institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave dhe në analizën e dokumenteve kombëtare, veçanërisht Programin Buxhetor Afatmesëm.

Gjithashtu projektligji parashikohet të ketë efekte financiare për operatorët sipas përlllogaritjes së reflektuar në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit.

MINISTËR

Evis SALA